



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

VENDIM

Nr. 6 . Dt. 13.03. 2013

MIRATIMIN NE PARIM

**“ MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR
PERROI I THATE KOMUNA KOLESJAN, QARKU KUKES
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA KOMPANIA
“ AL – CAN HYDROPAWER ENERGY ”, sh.p.k.
HEC LAJTHI ”.**

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga kompania “ **AL – CAN HYDROPAWER ENERGY** ” sh.p.k. per perdorimin e burimit ujore Perroi i Thate, fshati Domaj, komuna Kolesjan, Rrethi Kukës, per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin- Bune dhe udhezimit te Perbashket ne mes te M.M.P.AU. me M.E.T.E., rezulton se propozimi i mesiperme nuk ka te beje me projekte per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperme vepra e marrjes te ujit, do te ndertohet ne Perroin e Thate, ne kuoten + 1340 m. Ndertesa e centralit do ndertohet ne kuoten + 1000 m. Prurja mesatare ne vepren e marrjes eshte $Q = 0.094 \text{ m}^3/\text{sek.}$, Subjekti kerkon te shfrytetoje nje prurje $Q = 0.1124 \text{ m}^3/\text{sek.}$

Subjekti nuk do pengoje perdorimin e ujit per nevojat e komunitetit.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “ **PER KONCESIONET**” dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M. “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA

Kryetare

Voltana ADEMI

